



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202001968/8

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandohet kërkimi i mbështetjes prej Inspektoriatit Kombëtar për Mjedisin dhe Territorin me mjeteve dhe fuqi punëtore, në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv nr.1635, datë 20.02.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë*

Drejtuar : **Kryetarit së Zyrës të Përmbarrimit**
Z. Fitim Koçiaj

VLORE

Për dijeni : **Y.S.**
Adresa : Rruga Elbasan-Librazhd, Km 1, pranë ish-Rezervave të Shtetit,

ELBASAN

I nderuar z.Kryetar!

Institucioni i Avokatit të Popullit ka në proces shqyrtimi ankesën e shtetasit Y.S., i cili ankohet ndaj Zyrës së Përmbarrimit Vlorë, për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor civil të formës së prerë 1635, datë 20.02.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Vlorë, me Vendimit nr. 728, date 26.07.2018, me objekt, midis të tjerave:

"...Detyrimin e palës së paditur "Ana 2013": Shpk, të pushojë cënimin në ushtrimin e aktivitetit të palës paditëse Shoqëria "Y.S." Sh.p.k. duke mos penguar atë në kalimin në rrugën që të çon në zonën minerare 70/5 në Lepenicë, Vlorë, rrugë e përdorur edhe më parë nga pala paditëse..."

Në procesin e hetimit të kësaj çështjeje, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka kërkuar Zyrës së Përmbarrimit Vlorë, me shkresën nr. K3/Y3-3 Prot, datë 09.07.2020, informacion dhe shpjegime rreth veprimeve përmbarrimore të kryera për ekzekutimin e vendimit gjyqësor civil të formës së prerë nr.1635, datë 20.02.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, si dhe prezantimin e shkaqeve të cilat justifikojnë mosekzekutimin deri më sot të këtij titulli ekzekutiv.

Në përgjigje të kërkesës, ju me Tuajën nr.453/1 prot, datë 16.07.2020, informoni rreth veprimeve përbarimore të kryera në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv në fjalë. Në ekpozenë tuaj, lidhur me procedurat e kryera, si dhe prezantimin e arsyeve të moszekutimit deri më sot të vendimit gjyqësor të lartpërmendur, konstatohet moskryerja e veprimeve përbarimore për sigurimin e mjeteve dhe fuqisë punëtore, pranë Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit dhe Territorit, sikurse parashikuar në nenin 523 të Kodit të Procedurës Civile, ku thuhet, se:

*“Detyrimi për bashkëpunim
(Ndryshuar me ligjin nr.10 052, datë 29.12.2008, neni 22)*

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit, pa praninë e tij ose të një personi madhor të familjes së tij, me kërkesë të përbaruesit gjyqësor, detyrohet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, përbaruesi gjyqësor kërkon edhe pjesëmarrjen e dy dëshmitarëve të tjerë. Në rast nevoje, me kërkesë të përbaruesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit.

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të prishet objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, me kërkesë të përbaruesit gjyqësor, inspektorati ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe Inspektorati Kombëtar detyrohen të mbështesin përbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit”,

Ushtrimi i kompetencës, sikurse parashikuar në dispozitën ligjore të sipërcituara nuk ka ndodhur. Në Tuajën nr.453/1 prot, datë 16.07.2020, drejtuar Avokatit të Popullit, shpreheni, midis të tjerave, se:

“... Më datë 06.03.2020, sipas procesverbalit të mbajtur kryhet pjesërisht hapja e segmentit rrugor me ndihmën e mjetit të tipit skrep vënë në dispozicion prej Bashkisë Selenicë. Nuk u mundësua hapja totale e rrugës pasi ndodheshin rreth 8 masive gurësh të mëdhenj që skrepi nuk i lëvizte dot. Për lëvizjen e gurëve nevojitej skrepi i tonazhit të rëndë. Ndodhur në këto kushte për pjesën e ngelur të rrugës do të caktohej një datë tjetër për zbatimin e vendimit me qëllim sigurimin e njetit të nevojshëm”.

Pas datës 06.03.2019, informoni, se, Bashkia Selenicë, me shkresën nr.2385, datë 24.09.2019, ju ka bërë të ditur, se, nuk ka mjet në gjendje pune për të siguruar zbatimin e vendimit gjyqësor dhe për këtë shkak, pala kreditore ka marrë përsipër sigurimin e mjetit për në datë 26.09.2019. Në këtë datë, pra 26.09.2019, në Tuajën nr.453/1 prot, datë 16.07.2020, shpreheni, se, nuk u arrit sigurimi i mjetit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor prej palës kreditore.

Në situatën në të cilën është ndodhur dhe ndodhet procesi i ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, gjykojmë, se, kërkimi i bashkëpunimit me Inspektoriatin Kombëtar të Mjedisit dhe Territorit, është i domosdoshëm, pasi ky organ disponon mjete të cilat janë të nevojshme për zbatimin e vendimit gjyqësor, të cilat nuk disponohen prej Bashkisë Selenicë.

Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor civil të formës së prerë 1635, datë 20.02.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Vlorë, me Vendimin nr. 728, date 26.07.2018, deri më sot, cënon parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor në fjalë brenda një afat i arsyeshëm, në kuptim të nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, *“Për ratifikimin e Konvetës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore”*.

Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe për një zgjidhje ligjore të kësaj çështjeje, çmon me vend të bëj këtë rekomandim, duke shpresuar, se, do të ndihmoië për vënien në vend të së drejtës të shkelur ankuesit në fjalë.

Për arsyet e përmendura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin sanksionohet, se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”*, si dhe nenit 21/b i cili parashikon, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*.

REKOMANDOJMË

Kërkimin e mbështetjes prej Inspektoriatit Kombëtar për Mjedisin dhe Territorin me mjete dhe fuqi punëtore, në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv nr.1635, datë 20.02.2017, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë

Kthimi i përgjigjes, rreth këtij rekomandimi, konform parashikimit të kryer në nenin 19 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, të kryhet brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të këtij rekomandimi.

Duke besim në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA(CANAJ)